



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**

URDHËR

NR. 89 DATË 05 / 03 /2012

“PËR

**FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT E PAJISJES E ADMINISTRIMIT TË
VULAVE TË ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të Ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të nenit 282/3 të Ligjit nr.8901, datë 23.05.2002 “Për Falimentin” i ndryshuar, si dhe Vendimit nr.124, datë. 6.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare",

URDHËROJ:

1. Administratori i certifikuar i Falimentit paraqet kërkesë pranë Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit, për pajisjen me vulën e njomë.
2. Vula e njomë ka formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj shkruhen në formë të harkuar me shkronja kapitale fjalët "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" dhe poshtë tyre me shkronja kapitale më të vogla, shkruhet në një rresht të dytë në formë të harkuar emri, shkronja e parë e emrit të babait dhe mbiemri i Administratorit të Falimentit. Në mes konturohet shqiponja dykrenare dhe poshtë saj në formë harkore në të kundërt të emrit dhe mbiemrit të administratorit janë shkruar me shkronja kapitale, por të së njëjtës madhësi me ato të emrit, fjalët "ADMINISTRATOR FALIMENTI".
3. Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit paraqet kërkesën për përgatitjen e vulave, subjekteve shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur subjekteve private shqiptare ose të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente. Emrat e tyre miratohen paraprakisht nga Ministri i Drejtësisë. Administratori i Falimentit paguan paraprakisht tarifën tek subjekti që përgatit vulën.
4. Vulat i dorëzohen Drejtorit të Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit nga subjekti përgatitës i tyre. Vulat merren në dorëzim me procesverbal, të nënshkruara nga përfaqësuesi/t e përmendur sa më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit. Agjencia njofton administratorin që të paraqitet për marrjen në dorëzim të vulës.

përmendur sa më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit. Agjencia njofton administratorin që të paraqitet për marrjen në dorëzim të vulës.

5. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Drejtori i Agjencisë dhe nga Administratori i Falimentit. Në procesverbal shënohet koha, vendi, emrat e pjesëmarrësve, si dhe fakti i marrjes së vulës në dorëzim nga Administratori i Falimentit. Procesverbali hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga personat e lartpërmendur, ku secili mban një kopje të tij.
6. Pajisja e Administratorëve të Falimentit me vula bëhet nga Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së tij për t'u pajisur me vulë.
7. Institucioneve qendrore më të rëndësishme, si dhe subjekteve të tjera që vlerësohen nga Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit se kanë lidhje të ngushtë me veprimtarinë e Administratorit të Falimentit u dërgohet zyrtarisht, për çdo administrator, një fletë e bardhë e nënshkruar dhe e vulosur me vulën e tij.
8. Në çdo rast, modeli i vulave, emri dhe firma e çdo Administratori Falimenti i dërgohet për depozitim e model, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bankës së Shqipërisë, si dhe bankave të nivelit të dytë, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe gjykatave.
9. Vula është personale dhe përdoret vetëm nga Administratori i Falimentit. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t'u jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Në rast se gjatë kontrolleve, konstatohet se vula e Administratorit të Falimentit përdoret nga persona të tretë, atëherë përfaqësuesit e Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit, të ngarkuar me mbikqyrjen, pasqyrojnë faktin në procesverbalin përkatës dhe i raportojnë Ministrit të Drejtësisë.
10. Administratori i pajisur me vulë është i detyruar të kujdeset për ruajtjen e saj nga dëmtimet, vjedhjet dhe përdorimin nga të tretët.
11. Administratori, i cili kërkon të pezullojë veprimtarinë e tij dhe që është pajisur me vulë, duhet të dorëzojë në Agjencinë e Mbikqyrjes së Falimentit vulën e tij. Procesverbali dokumenton dorëzimin, hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit dhe nga Administratori i Falimentit, ku secili mban një kopje të tij.
12. Administratori, i cili kërkon të rifillojë veprimtarinë, duhet të paraqesë kërkesë, për marrjen e vulës së tij, pranë Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit.
13. Administratori, i cili cregjistrohet nga regjistri i Administratorëve të Falimentimit, si rezultat i skadimit të licencës, dhe që është pajisur me vulë, duhet të dorëzojë për asgjësim në Agjencinë e Mbikqyrjes së Falimentit vulën e tij. Procesverbali dokumenton dorëzimin dhe asgjësimin, si dhe hartohet në dy kopje dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit dhe nga Administratori i Falimentit, ku secili mban një kopje të tij.
14. Pas asgjësimit të vulave Agjencia e Mbikqyrjes së Falimentit vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar më parë modeli i vulës dhe firmës së administratorit, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe se dokumentacioni i

paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat duhet konsideruar i pavërtetë.

15. Kur administratori, i cili është çregjistruar nga regjistri i Administratorëve të Falimentit në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit nuk dorëzon vulën, Agjencia vë në dijeni institucionet, të cilave u është dërguar modeli i vulës së administratorit dhe firma e tij, se personi nuk e ushtron më veprimtarinë, se ato vula nuk janë më në përdorim dhe dokumentacioni i paraqitur me vula sipas modelit të treguar, pas datës kur janë asgjësuar vulat, duhet konsideruar i pavërtetë.
16. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit dhe Administratorët e Falimentit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
EDUARD HALIMI

